



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 19.05.2023

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 12.05.2023.

Znj. _____

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 12.05.2023 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1. Si është i organizuar shërbimi veterinar në bashkinë tuaj?

- Kemi një punonjës specialit veteriner I cili është në varesi te sektorit te pyjeve dhe kullotave.

2. Sa veteriner janë në strukturën e shërbimit veterinar?

- Nje specialist.

3. Sa është fondi i përcaktuar në buxhet për shërbimin veterinar në 5 vitet e fundit (specifikojeni sipas secilit vit)?

- Asnjë fond.

4. A keni hartuar program pune të profilaksisë veterinare në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si edhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre?

-Jo

- Nëse po, na e vendosni në dispozicion;

5. A i keni identifikuar qentë dhe macet e rrugës në territorin që administroni?

-Jo se për arsye është një numër shumë i vogël.

- Nëse po, sa është numri i tyre në 5 vitet e fundit?

(nëse i keni të ndara sipas muajve, njësive administrative, ju lutem specifikojeni);

6. Si e organizoni sterilizimin e organeve të riprodhimit të qenve dhe të maceve të rrugës?

-Nuk kemi kryer sterilizime.

7. Si i grumbulloni qentë dhe macet e rrugës?

-Nuk kemi grumbulluar.

8. A keni vende të posaçme, të miratuara, në të cilat i dërgoni?

-Jo.

9. Në cilat raste realizoni eliminimin e qenve dhe të maceve të rrugës dhe si e realizoni procesin?

-Nuk kemi kryer eliminime.

- Nëse i keni eliminuar ato për arsyet që do i listoni, ju lutemi na informoni për numrin e qenve dhe maceve të eliminuar në 5 vitet e fundit (specifikojini sipas secilit vit);

10. A keni konstatuar raste ku ka pasur braktisje të qenve dhe maceve nga pronarët përkatës dhe çfarë masash keni marrë?

-Jo.

11. Çfarë masash keni marrë që në ambientet publike, si: rrugë, parqe, kënde lojërash etj., kafshët e shoqërimin të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose për kafshët e tjera?

-Kemi bërë sensibilizimin me anë të njoftimeve.

12. Çfarë masash keni marrë për të vendosur dhe për të zbatuar në territorin që administroni, detyrimin për pronarët që të vendosin maskën mbrojtëse në gojë për qentë e shoqërimin të racave agresive gjatë qëndrimit të tyre në ambientet publike?

-Kemi bërë njoftimet përkatëse.

13. A keni konstatuar raste të helmimit të qenve dhe të maceve të rrugës?

-Jo.

- Nëse po, si keni vepruar në këto raste?

14. A keni referuar tek autoritetet ligjzbatuese raste të braktisjes, helmimit apo të vrasjes së qenve apo të maceve të rrugës?

-Nuk kemi konstatuar rastet e tilla.

- Nëse po, na informoni për secilin rast;

15. A keni informacion për sjelljen e maceve dhe kafshëve të rrugës nga territore të tjera të vendit në territorin e bashkisë suaj?

-Jo nuk kemi informacion.

16. A keni marrë ankesa për mënyrën se si e menaxhoni situatën e maceve dhe të qenve të rrugës?

-Jo.

- Nëse po, na informoni për numrin e tyre në 5 vitet e fundit;

17. A keni ngritur qendra vaksinimi, kastrimi dhe sterilizimi për macet dhe qentë e rrugës?

-Jo.

Nëse po, na informoni për adresat e tyre dhe numrin e kafshëve të trajtuara, matrikulluara në 5 vitet e fundit, ndarë sipas kategorive, qen, mace, mosha, tipologjia, etj.;

18. A keni qendra të ngritura për macet dhe qentë e rrugës?

-Jo.

- Nëse po, si funksionojnë ato, a janë të përkohshme, të përhershme etj.?

- Si mundën qytetarët t'i vizitojnë qendrat tuaja dhe si e siguronit transparencën për punën tuaj?

19. A keni strehëza të përhershme të ngritura për macet dhe qentë e rrugës që janë në pritje të adoptimit?

-Jo.

- Nëse po, si funksionojnë ato?

20. Si funksionon adoptimi i qenve dhe i maceve të rrugës që ju i grumbulloni në territorin tuaj, nëse e ofroni këtë shërbim?

-Nuk kemi qendra grumbullimi dhe adoptimi.

Faleminderit për mirëkuptimin!